



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 060/01-3901/23
Kaçanik, 17.02.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Solemne e Kuvendit të Komunës Kaçanik , për nder të 15 vjetorit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, mbajtur më 17.02.2023 (e premte). Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 10:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin, 26 anëtarë .

Nga ekzekutivi i komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, nënkryetari i komunës-Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive komunale: Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Zahir Doda, Qamil Stagova, Dardana Dauti, Pranvera Loku-Zharku, Hafize Sallahu, Suhad Dullovi dhe Sali Malsiu. Nga zyrtarët komunal ka qenë Fatlume Guri-Selimi.

Të pranishëm në këtë mbledhje kanë qenë: Xhabir Zharku -Kryetar i OVL, Rustem Dema, Kjani Zeneli.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari ju përshëndes dhe ju falenderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të komunës, për nder të 17 shkurtit, ditës së Pavarësisë së Kosovës. Në këtë mbledhje është paraparë ky:

REND PUNE

- 1.Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të komunës;
- 2.Fjala përshëndetëse e Kryetarit të komunës, Besim Ilazi;
- 3.Fjalë përshëndetëse e përfaqësuesve të subjekteve politike në kuvend;
- 4.Fjala përshëndetëse e përfaqësuesve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së

- 1.Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të komunës

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:

I nderuar Kryetar i komunës z.Besim Ilazi, i nderuar nënkryetar i komunës z.Sabedin Vishi, të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta dhe mysafir të nderuar, shfrytëzoj rastin që në emrin tim dhe në emër të kuvendit të ju uroj juve dhe të gjithë qytetarëve të Kaçanikut, festën pavarësisë apo 15 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kemi ftuar këtë seancë solemne të Kuvendit Komunal duke shfrytëzuar të drejtën tonë ligjore për të shënuar një ngjarje të rëndësishme, ndër më të rëndësishmet pas çlirimit të vendit, 15 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Kur shënojmë ngjarje si kjo me peshe historike kombëtare është e pamundur që të mos kthehemi mbrapa e të kujtojmë të kaluarën tonë të lavdishme, mundin dhe sakrificën e popullit tonë, andaj për të nderuar gjithë ata që u sakrifkuan ju ftoj ti nderojmë me një minutë heshtje. LAVDI!

Kosova dhe populli shqiptar sot kremtojnë 15 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe në kuadër të shënimit të kësaj ngjarje janë organizuar manifestime të ndryshme nga autoritete qendrore dhe lokale dhe nga organizata të ndryshme.

Të gjitha këto organizime për shënimin e përvjetorëve të pavarësisë kan si kujtim, emërues të përbashkët të kaluarën tonë të lavdishme, e shumë luftëra e sakrifica, me shumë gjak të derdhur ndër shekuj nga bij e bija më të mirë të kombit kundër pushtuesve të ndryshëm, që populli ynë të frymojë lirshëm. Pas shumë sakrificave e luftërave shekullore, liria e Kosovës u kurorëzua me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me gjakun e derdhur të shumë heronjëve, dëshmoreve dhe martirëve.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, sakrifica e familjes Jashari dhe lufta heroike e komandantit legjendar Adem Jashari dhe e shumë heronjëve dhe dëshmoreve anekënd vendit, u bënë gurthemel i fuqishëm i shtetit të pavarur të Kosovës.

Kaçaniku si vend i njohur për luftëra të lavdishme në periudha të ndryshme nga koha e Idriz Seferit, e këtij zë vend të rëndësishëm në faqet e historisë për sakrificat për çlirimin e pavarësimin e vendit tonë. Edhe në luftën e fundit bijtë dhe bijat më të mirë Kaçanikas të prirë nga komandantët tashmë heronj të kombit Agim Bajrami dhe Qamil Ilazi, luftuan deri në vetëflijim për të sjellur frymën e lirisë që ne gëzojmë sot, për të cilët ne çdo herë do përkulemi në nderim dhe përkujtim të jetës dhe veprës heroike të tyre. Kur jemi në këto momente të shënimit të ngjarjeve të veçanta historike, nuk mund të mos përmendim edhe personalitete të veçanta pa kontributet sakrificën e tyre nuk do ishim ne këtu sot.

Edhe në këtë përvjetor ne shënojmë 17 shkurtin ditën e pavarësisë së Kosovës, pa protagonistët kryesore të kësaj ngjarje pa presidentin Hashim Thaçi, kryekuvendarët Veseli e Krasniqi, deputetin Selimi, pa Hysniun, Nasimin, Calin dhe Pjetrin që po përballen në gjykatën e Hagës me akuza të pabaza dhe të fabrikua nga Beogradi.

Në këto 15 vite të shtet ndërtimit, Kosova ka ecur sigurt në rrugën e saj të zhvillimit, duke falënderuar edhe partnerët tanë ndërkombëtarë të cilët luajtën rol të rëndësishëm në çlirimin dhe pavarësimin e vendit tonë. Ne të gjithë e sidomos në të zgjedhurit nga vota e popullit duhet të punojmë fort për të realizuar dhe ndërtuar atë për të cilën shumë breza para nesh luftuan e punuan. Me angazhimet dhe punën tonë të dinjitetshme dhe të përditshme ne mundohemi të lehtësojmë jetën e qytetareve tonë nga të cilët kemi marre besimin dhe përgjegjësitë, por në të njëjtën kohë mundohemi të realizojmë edhe ëndrrën dhe amanetin e atyre që nuk patën fatin të shijojnë lirinë. Puna me përkushtim dhe përgjegjësi është obligim që na la e kaluara jonë e lavdishme.

Gëzuar Pavarësinë e Kosovës dhe Lavdi të gjithë atyre që dhanë jetën për këtë ditë!

Kryetari i komunës, Besim Ilazi:

Të nderuara familje të dëshmorëve,invalidëve,veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i nderuar Kryesues i Kuvendit z. Kemajl Murseli, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta,të nderuar asambleist, të nderuar mysafir dhe gjithë ju të pranishëm të tjerë. Kam nderin që sot në këtë seancë solemne, të ju drejtohem, me një fjalë rasti me rastin e shënimit të përvjetorit jubilar të Pavarësisë së Kosovës.

17 Shkurt 2008, është dita kur na bashkoi të gjithëve, dita më me fat e Kosovës së pasluftës. Ditë kur kulmoi ideali ynë për lirinë dhe pavarësinë e shtetit tonë. Padyshim, kjo ditë është kupola e sakrificës, e përkushtimit të burrave dhe grave të këtij kombi, që me shekuj të tërë, qëndruan stoikisht, ndaj një armiku që kishte vetëm një qëllim spastrimin etnik të shqiptarëve ndër vite e shekuj. Ishte guximi dhe lavdia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën udhëheqjen madhështore të Komandantit Adem Jashari. Ishte shkëlqimi dhe penda e ndritur e shumë intelektualëve e mësuesve, të cilët, pa u ndalur asnjëherë e sy pa trembur, mbollën dhe

shpërndanë dijen për atdhedashurinë e patriotizmin. Ishte zëri i shumë artistëve, që përmes këngës e poezisë edhe në kohërat më të vështira, kënduan e thurën vargje për heroizmin dhe lavdinë e trimërisë.

Është sakrificat e përkushtimi i të gjithë qytetarëve të komunës sonë, që tashmë janë bërë pjesë e historisë më të re e më të dhimbshme të Kosovës sonë. Janë Komandantët Agim Bajrami e Qamil Ilazi, të cilët së bashku me shumë trima të anës sonë, u bënë pjesë e betejave dhe fronteve mbrojtëse të lirisë sonë. E sot jemi po ne, që kemi në dorë të ardhmen e shtetit tonë. Jemi po ne ata, që në çdo kohë e moment, ta trasojmë atdhedashurinë tek brezat e rinj, të ju tregojmë atyre që rruga e lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë është ndërtuar mbi themelet e gjakosura të vajzave e djemve të mirë që kishte kjo tokë arbërore. Jemi po ne, ata që çdo ditë duhet të punojmë që këtë shtet ta fuqizojmë, duke përkrahur prodhuesit vendor, duke krijuar kushte sa më të mira për zhvillim ekonomik e zhvillim në Arsim, duke bërë më të mirën secili nga ne, që në këtë tokë e në këtë vend të ketë jetë, të ketë rini, të ketë profesionist, sepse pa ta ky vend nuk mund të ketë avancim.

Të nderuar të pranishëm, edhe në këtë përvjetor shtetësisë e Kosovës është më e zbehtë e më e brishtë, në këtë festë ndiejmë mungesën e krerëve të UÇK- së, arkitektëve të lirisë e pavarësisë së Kosovës, të cilët padrejtësisht po gjykohen nga Gjykata Speciale. Urojmë që përvjetorin tjetër, ta festojnë në Kosovë, në vendin për të cilin dhanë e punuan shumë.

Gëzuar qytetar të Republikës së Kosovës!

Lavdi dëshmorëve dhe gjithë të rënëve të cilët bënë të mundur që ne sot të festojmë shtetësinë e Kosovës.

znj.Fitore Vishi: I nderuar Kryetar, z. Besim Ilazi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, z. Kemal Murseli, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta, të nderuar kolegë dhe kolege – asambleist, Drejtorë të drejtorive komunale, të nderuar të pranishëm.

15 vite më parë, Parlamenti i Republikës së Kosovës e shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovaran. Në këtë mënyrë u bë realitet ëndrra shekullore e popullit tonë për liri e pavarësi dhe Kosova përgjithmonë u shkëputë nga kolonializmi serbo-sllav. Kjo e arritur e sublime nuk do të arrihej pa sakrificën e pareshtur të burrave e grave të popullit tonë dhe pa të lavdishmen Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Ne dhe të tjerët që do të vijnë pas nesh, gjithmonë duhet ta kemi parasysh se themelet e Kosovës së lirë dhe të pavarur u ngritën mbi lumenj gjaku të atdhedashësve dalzotës të atdheut, dëshmorëve dhe heronjëve tanë.

Është e papranueshme që edhe këtë përvjetor, Kosova e pret pa liderët historik dhe arkitektët e pavarësisë së saj. Në anën tjetër, Serbia dhe Rusia putiniste vazhdojnë të jenë një kërcenim i madh për paqen dhe stabilitetin e Republikës së Kosovës, por e kanë të kotë sepse ne mund të vazhdojmë tutje përpara por përgjithmonë që të kthehemi mbrapa kjo nuk do të ndodhë asnjëherë.

Të nderuar pjesmarrës/e, uroj që përvjetorët tjerë ti presim e festojmë bashkë me çlirimtarët tanë, të cilët padrejtësisht vazhdojnë të mbahen në qendrën e paraburgimit në Hagë dhe bashkë me ta të vazhdojmë rrugën e konsolidimit, zhvillimit më të hovshëm dhe forcimit të shtetit tonë.

Gëzuar Festën e Pavarësisë së Kosovës!

Lavdi Dëshmoreve dhe gjithë të rënëve për liri, çlirim e bashkim.

z.Bashkim Luma: I nderuar Kryetar i Komunës z. Besim Ilazi, nënkryetar z. Sabedin Vishi, Kryesues i kuvendit z. Kemal Murseli, të nderuar kolegë të Kuvendit e drejtorë të ekzekutivit, të nderuara dhe shumë të respektuara familje të dëshmorëve, martirëve, invalidë e veteran të luftës, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta, të dashur qytetarë të komunës së Kaçanikut, të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës.

Sot në këtë datë të 17 shkurtit jemi mbledhur në këtë seancë solemne të Kuvendit të Komunës për nder të 15 vjetorit të Republikës sonë.

Ky përvjetor, si çdo përvjetor tjetër i kaluar, padyshim që na përkujton të gjithëve vlerën e sakrificës, guximit, vetëmohimit, atdhedashurisë e angazhimit të pashoq të shumë gjeneratave për liri e pavarësi, që sot të gjithë ne së bashku e gëzojmë dhe e festojmë në paqe e qetësi. Këto vlera madhështore duhet patjetër apo domosdoshmërisht të kultivohen gjeneratë pas gjenerate. Ashtu siç erdhëm deri tek dita e shpalljes së pavarësisë, me shumë mund e punë të pandalshme, gjithsesi duhet që edhe nga pozitat udhëheqëse e nga çfarëdo lloj pozicioni që secili prej nesh ka në këtë Republikë, duke lënë anash interesat e ulëta personale e klanore, duhet të vazhdojë kontributin e tij për shtetndërtimin e forcimin e këtij vendi në secilën sferë jetësore. Dhe kjo duhet të bëhet pandërprerë e deri në frymën e fundit.

Së fundmi nga ky Kuvend i Kaçanikut historik, shfrytëzoj rastin që në emër të Lëvizjes VETËVENDOSJE! – Qendra në Kaçanik, të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës t'ua uroj festën e pavarësisë së Kosovës, e përvjetorin e 15 të saj.
Gëzuar!

znj. Ardita Rrahmani: I nderuar Kryetar i komunës z. Besim Ilazi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta, të nderuara dhe shumë të dashura familje të dëshmorëve, kolegë asambleist, ekzekutiv, qytetarë të komunës.

Zonja dhe Zotrinje,

“Liria nuk ipet kurrë vullnetarisht nga shtypësi, ajo duhet kërkuar nga atë shtypurit”- e kujt më mirë se Kosovarëve të shtypur ndër vite, do të i shkonte për shtati kjo shprehje.

Ndër vite të shtypur, nënqmuar, asimiluar e përndjekur Kosovarët e njohën mirë se çka është të qenit të robëruar.

Historia e Republikës së Kosovës nuk fillon në pavarësimin e saj, 17 Shkurti është fundi i një shekulli të larë në gjak, është fundi i një sundimi dhe nënqmimi dhe fundi i një epoke të vështirë për paraardhësit, për ata që edhe ëndërr po të e shihnin lirinë- do të ndëshkoheshin të nesërmen për ndërdijen e tyre. Por Ëndrrat nuk u shuan as kur dhanë djem e vajza të shumta, as kur u përzunë nga shkollat, as kur u përzunë nga puna, as kur u burgosen e malltretuan. Ëndrrat e një populli liridashës nuk u shuan as kur u vranë nga okupatori e nuk do të shuhën as sot e asaj dite kur edhe bota e njohu agresorin.

Me krenarinë më të madhe sot, le të kujtojmë secilin antarë të Lëvizjes Nacionale Demokratike Shqiptare të viteve 40-ta, pasuar me demonstrata e fundviteve të 60-ta nga studentët Kosovarë. Hap sado i vonshëm por me kthesë historike për Kosovarët padyshim që mbetet themelimi i Universitetit të Prishtinës, Akademia e Arteve dhe Shkencave, si dhe Radio televizioni i Kosovës, institucione këto që i çelën rrugë ngritjes intelektuale e kulturore dhe zhvillim të përgjithshëm të popullsisë kosovare. Demonstratat e viteve 80-ta ju dha edhe tjetër epilog vrasja nga shërbimet sekrete serbe në Gjermani tre udhëheqësit e Lëvizjes Popullore, vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka.

Deklarata e Pavarësisë së 2 Korrikut e Kushtetuta e Kaçanikut 7 Shtator të 1990, u dhanë Kosovarëve motiv dhe forcë-bashkim dhe qendresë kundrejt okupatorit, ani pse në kushte edhe më të vështira sepse tashmë dalja në pah e paknaqësive ndaj tyre ishte evidente.

Zgjedhjet e para Demokratike me Kryetar Ibrahim Rugovën, njeriu që organizoi rezistencën paqësore nga pushtuesit e me krenarinë po aq të madhe kujtojmë edhe Anton Qeten veprimatrin e pajtimit të gjaqeve në vitet e 90-ta.

Kulminacioni arriti me daljen në pah të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Ushtri kjo pa të cilën historia moderne e shtetit tonë të ri nuk do të ishte kjo që sot është. Sot le të kujtojmë secilin dëshmor, veteran, ushtar të UÇK-së.

Çdo përpjekje ndër vite nuk ishte e mjaftueshme për të i dhënë fund shtypjes shumëvjeqare, prandaj edhe eksodi dhe dhuna në popullatën civile veq se rritej dhe se vrasja e komandantit legjendar Adem Jashari, sikur mobilizoi edhe më shumë popullin për mobilizim.

Ky mobilizim do të ishte i pamjaftueshëm dhe i pa rezultat nëse vendet mike si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Europian do të qendronin indiferentë ndaj situatës që po ndodhte në Ballkan.

Përjetë e mot falenderuese vendeve mike të Republikës sonë për kontributin e pashoqë drejt lirit tonë dhe dhënjes së mundësisë së ruajtjes së paqes në gjithë rajonin.

Kosova meriton më shumë, Kosova mundet më mirë.

Gëzuar 15 vjetori i Pavarësisë së Kosovës!

znj.Rabije Sallahu: I nderuar Kryetar, i nderuar Kryesues, të nderuar Asambleistë, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta, të nderuar të pranishëm.

Sot kujtojmë shumë sakrifica që i kan para prirë kësaj dite të jashtzakonshme, po flasim për një nga temat që ka për zemer secili prej nesh, Ditën e Pavarësisë së Kosovës 17 shkurt i 2008-ës një vitë i pa harruar. Duke kujtuar nënat dhe baballarët të cilët përjetuan vështërsitë të pa përshkrueshme në mënyrë që bijët dhe bijat e tyre të mund të jetojnë të lirë. Viti 2008 është vet historia e popullit tonë, duke kujtuar këtë ditë na vien vërdallë kujtime nga lufta, e sakrifica e popullit. Rruga për tu pavarësuar nuk ka qenë aspak e lehtë, një rrufe e përgjakur mbi trupa të vdekur e heronjë kombi.

Sot këtu kujtojmë Adem Jasharin dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që e quan tutje vullnetin e popullit të Kosovës për të qenë të lirë. Kujtojmë UÇK-në, kujtojmë luftën e saj të drejtë, kujtojmë betejat e lavdisë. Pavarësia jonë është arritur me përpjekje të shumta dhe ajo që fituam është mundësia e realizimit të ëndrrave tonë, ëndrrat për veten fëmijët dhe shtetin tonë. Derisa kujtojmë të kaluarën e Kosovës së bashku presim dhe i besojmë të ardhmes së saj. Një e ardhme e ndërtuar mbi heronjë. Kosova është atdheu ynë që nuk falet, me mundësi dhe të drejta të barabarta.

Mbesim me shpresën që Kosovën ditë më të mira po e presin. Lavdi heronjve, dëshmorëve të kombit dhe gjithëve të rënëve për liri.

Urime dita pavarësisë së Kosovës!

z.Agim Çaka: I nderuar Kryetar z.Besim Ilazi, i nderuar Kryesues i Kuvendit z.Kemal Murseli, të nderuar Asambleistë, të nderuar përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta, të nderuar të pranishëm.

Kam kënaqësinë që sot në këtë datë, para jush të mbaj këtë fjalim me rastin e 15 vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Duke iu drejtuar këtij kuvendi, e përmes kuvendit gjithë qytetarëve tanë, shfrytëzoj rastin ti uroj të gjithë për këtë moment historik jo vetëm për shqipëtarët e Kosovës por gjithë shqipëtarët kudo që janë. Duke pas parasysh se për të arritur deri te ky moment historik, u sakrifikuam shumë e shumë gjenerata që kishin bërë përpjekje ndër shekuj e dekada. Ne jemi gjenerata më me fat, që e përjetuam dhe po e gezojmë këtë kulmim të kësaj sakrifice prandaj do të jemi mirënjohës sot, neser dhe pergjithmonë.

Kur kujtojmë pavarësinë, kujtojmë se ajo ishte një rrugë mjaft e vështirë, e vështirë por me një cak të vetëm pa alternativë. Rruga e lirisë për këtë popull të shtypur ndër vite.

Kur kujtojmë pavarësinë, nuk kthehemi vetëm 15 vite prapa, por ikin vite e dekada prapa duke kujtuar vuajtjet, torturat e malltretimet e të parëve tanë, aktivitetin dhe luftën e tyre për tu mos u dorëzuar deri në vdekje.

Kur kujtojmë pavarësinë, na kujtohen demonstratat e viteve 68, 81, protestat e viteve 90, ndjekjet dhe përndjekjet, burgjet dhe vrasjet pa kursyer moshë as gjini. Pra pavarësia e Kosovës nuk erdhi vetëm pse dikush e donte atë, por se dikush punoi e dikush edhe u flijua për të.

Pavarësia e Kosovës, përfundimisht erdhi si rezultat i vendosmërisë së djemve e vajzave të këtij populli që përmes luftës së hapur të armatosur ti tregojnë armikut dhe faktorit ndërkombëtar se një popull i shtypur ndër vite ishte gati të vdiste për liri. Qindëra e mijëra varre të dëshmorëve të këtij vendi janë dëshmi e faktuar e kësaj sakrifice sublime, varre para të cilave do të përulemi përjetësisht me nder dhe respekt.

UÇK-ishë vula më bindëse me të cilën do të vulojë Pavarësia e Kosovës. Të rreshtuar në frontin e lirisë, me plot vullnet, madje edhe me dëshirën për të vdekur, djemtë dhe vajzat më të mira të këtij vendi, me mbështetje gjithpopullore nisen një luftë të pabarabartë në njerëz dhe teknikë

por me një motiv shumë më të fortë, sepse po bënin një luftë të drejtë në tokën dhe për tokën e tyre. Plotësisht të vetëdijshëm për pasojat, liria për ta s'kishte alternativë.

Edhe e dinin që mund të vriteshin, por që dikush do ta gezonte lirinë ishin më të sigurtë. Lufta e drejtë, e pastër bëri që edhe faktori ndërkombëtar të rreshtohet në anën tonë gjë që përshpejtoi ndalimin e luftës dhe arritjen e qellimit final, çlirimin nga pushtuesi për çka edhe miqve tanë dhe aleatëve u jemi mirnjohës sot e përgjithmonë.

Gjeneratat e reja duhet ta dinë se Pavarësia nuk ishte e lehtë, u pagua një çmim për të, u derdh gjak për të. Betejat tona nuk kan përfunduar me ardhjen e pavarësis. Ato beteja vazhdojnë dhe do të vazhdojnë nga gjenerata në gjeneratë. Ato beteja do të zhvillohen me punë dhe përkushtim deri në përmbylljen e plotë të procesit të pavarësisë për një shtet të fortë dhe të qëndrueshëm, nga i cili nuk largohen rinia dhe qytetarët e sajë sepse lufta për ndërtimin e shtetit nuk është më e vështirë se lufta për bërjen e shtetit edhe në betejën për ndërtimin e shtetit ka nevojë për djem e vajza patriot të cilët e duan me zemer këtë vend dhe janë në gjendje të japin gjithçka që shteti të bëhet shtet. Pra pavarësia është e jona, është e të gjithëve, nuk është privilegj por është përgjegjësi.

Sot në 15 vjetorin e saj jo të gjithë janë këtu me ne, figurat kryesore të UÇK-së vazhdojnë betejën e tyre për ta mbrojtur luftën e tyre të drejtë në një gjykatë të padrejtë me të vetmin qëllim, njollosjen e luftës së tyre të pastër. Besojmë në pafajsinë e tyre dhe urojmë kthimin sa më të shpejt të tyre në vendin e tyre, pran njerzve të tyre.

Po e përmbyll këtë fjalim me një thënie të patriotit Hasan Prishtina i cili para sa e sa viteve ka thënë se "Atdheu gjithmonë ka nevojë për njerëz të cilët punojnë për të".

Pra edhe sot pas sa viteve na duhet të kujtojmë fjalët e Hasan Prishtinës duke mos menduar se historia fillon dha mbaron me ne. Edhe njëherë për fund, juve dhe gjithë shqiptarve kudo që janë.

Gëzuar 15 vjetori i Pavarësisë së Kosovës!

z.Xhabir Zharku: Jemi këtu sot për të përkujtuar 17 shkurtin ditën e shpalljes së pavarësisë, një ditë për të cilën është bërë një sakrifice shume e madhe për të ardhur deri këtu dhe Kaçaniku ka se në çka të krenohet. Është një vazhdimësi e rrugës për çlirim dhe mund të themi që nga historia e re e 10-të qershorit të vitit 1878, kur burrat e asaj kohe në lidhjen e Prizrenit krijuan ushtrinë dhe qeverinë e parë shqiptare për ti bashkuar të gjitha trojet shqiptare në një shtet. Dhe nga ajo ditë por edhe më herët, shqiptarët nuk pushuan me penë e me pushkë deri në ditën e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë por edhe më vonë me 17 shkurt 2008 të Kosovës. Besoj që edhe rinia jonë nuk do të pushojë deri në forcimin e shtetit, deri në jetësimin e gjithë amanetit të brezave të kaluar, deri sot.

Atëherë kur në Ish-Jugosllavi, shpresat shuheshin, shqiptarët prapë protestonin e demonstironin dhe kërkonin liri dhe të drejtat e tyre, mirëpo shumë kush nuk guxonte të ngrinte zërin, por ne kishim fatin që të kishim në mesin tonë në komunën tonë burrin e madh Sali Bajra, i cili ju tha "Këtu nuk kaloni, këtu është Kaçaniku me burra dhe gra që do ti del zot atdheut". Atëherë kur çdo shpresë shuhej dhe mbylleshin dyert për shqiptarët, ishin burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat që hapnin dyert e kancelarive botërore deri në Washington, për të kërkuar të drejtën e tyre të shtypur dhe nëpërkëmbur. Atëherë kur mendonin se shqiptaret do të largoheshin ishte ai djali i ri, ai burri fisnik dhe i fort Ismail Raka, që ju tha "Ne jemi këtu".

Atëherë kur menduan që shqiptarët nuk do të ekzistojnë, ishte familja Jashari që i tregoi botës se ne dimë të sakrifikohemi deri në vetë flijim dhe Kosovën nuk e lemë pa Zot. Ishte ajo frymë e cila na frymëzoi neve në Kosovë dhe jashtë Kosovës, që të bëhemi zot të truallit tonë, të atdheut tonë e të kombit tonë. Ishte ai burrë i madh që la familjen e tij në diasporë Agim Bajrami, që erdhi me pushkën e tij dhe ju tha rinisë së Kaçanikut dhe gjithë Kosovës, se ne dimë ti dalim zot vendit tonë edhe me pushkë.

Ishte ai trim dhe burrë komandanti Qamil Ilazi, që unifikoi të gjitha grupet guerile në Kaçanik dhe në krye të Brigadës 162 "Agim Bajrami", vazhdojë amanetin të atyre trimave për liri dhe pavarësi deri në fljimin e tij për lirinë e Kosovës. Ishin këta djem dhe burra që sollën këtë liri

qe sot e gëzojmë. Sot jeni ju asamblastët e komunës së Kaçanikut, që do ti jepni sot, nesër dhe pasnesër frymë vendit tonë, duke i mbrojtur interesat e komunës tonë, duke i mbrojtur ato me identitetin më të madh, sepse Kaçaniku për ne për ju dhe për gjithë qytetarët tonë është me i rëndësishëm, njëjtë sa është i rëndësishëm edhe kombi. Ju uroje ditën e pavarësisë dhe gëzuar për shumë mote.

















Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Nëse dëshiron edhe dikush tjetër të marrë fjalën, urdhëroni. Nëse jo atëher të gjithëve ju uroj 17 shkurtin, festën e Pavarësisë së Kosovës. Nën organizimin e Kryetarit të komunës, në ora 10:40 do të ketë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve, ndërsa në ora 11:30 do të ketë Akademi festive, te Shtëpia e Kulturës “Xheladin Kurtaj”.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

Nga Mbledhja e I (Parë) Solemne e Kuvendit të Komunës për vitin 2023, mbajtur me 17 Shkurt 2023:

- | | |
|-------------------------------|---|
| 1. Kemal Murseli |  |
| 2. Brahim Imishti..... |  |
| 3. Hamide Luma |  |
| 4. Kadri Krivenjeva |  |
| 5. Fitore Vishi,..... |  |
| 6. Rustem Zenuni,..... |  |
| 7. Edon Baftiu |  |
| 8. Selajdin Troni |  |
| 9. Fatmir Bunjaku |  |
| 10. Bashkim Krasniqi |  |
| 11. Florina Lika-Vishi |  |
| 12. Lejla Muhaxheri-Çaka..... |  |
| 13. Agim Mani |  |
| 14. Kadrije Lika-Troni |  |
| 15. Adnan Reka |  |
| 16. Naim Beça |  |
| 17. Raif Kasa |  |
| 18. Ernesta Krasniqi,..... |  |
| 19. Bashkim Luma |  |
| 20. Arta Avdiu |  |
| 21. Ardita Rrahmani |  |
| 22. Besnik Salihu |  |
| 23. Betim Shala,..... |  |
| 24. Arlinda Rakoci-Raka..... |  |
| 25. Rabije Sallahi..... |  |
| 26. Ekrem Livoreka..... | |
| 27. Agim Çaka..... | |